



KONTRATE SHITJE KUOTASH

Sot me date 29/05/2018 (*dymije e tetembedhjete*) para meje noteres **Joana M.Kushe** antare e dhomes se notereve Tirane, me seli Barrikadave, u paraqiten personalisht palet te cilet me kerkuan perpilimin e kesaj kontrate si me poshte vijon;

SHITESI: **Jeffrey Michael Thimm**, i dtl 02.06.1985 lindur ne Port-AU-Prince dhe banues ne Tirane, mbajtese e Pasaportes nr. Personal C4X6NFT4F, zoterues i 40% te kutoave te kapitalit themeltar te PEMLA shpk.

BLERESI: **Ana Shima**, e dtl. 17.07.1982 lindur dhe banues ne Tirane, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar nepermjet leternjoftimit nr. Personal I25717135J zoterues i 60% te kutoave te kapitalit themeltar te PEMLA shpk.

Personat e mesiperm te cilet ne vazhdim te kesaj kontrate do te thirren shkurt "shitesi" dhe "bleresi" me kerkuan perpilimin e kesaj kontrate si me poshte:

Sipas Ekstraktit te Q.K.R Tirane, **Pemla shpk**, eshte regjistruar si person juridik per te ushtruar aktivitetin e saj me **Objekt:** Perpunim te lendes se pare ushqimore ne produkte ushqimore per tregun dhe konsumatoret, Kultivimi i lendes se pare ushqimore, Import & Eksport i lendes se pare ushqimore dhe produkteve ushqimore. Promovimi i praktikave bujqesore te qendrueshme dhe standarteve te reja te perpunimit dhe prodhimit ushqimoretj.

Me vullnetin e tyre te lire e te plote shitesi me cilesine e ortakut te Pemla shpk i shet bleresit 40% te kapitalit themeltar ose 1 kuote te kapitalit qe ai zoteron ne kete shoqeri deklarom se e eshte likujduar nga bleresi .

Bleresi i mesiperm e pranon blerjen e 40 % te kuotave te kesaj shoqerie dhe deklarom se e ka likujduar shitesin jashte kesaj zyre Noteriale ne shumen 40.000 leke qe eshte vlere e 40% te kuotave.

Pas perpilimit te kesaj kontrate shitje, shitesi zhvishet nga pronesia e 40% te kapitalit themeltar qe zoterom ne Pemla sh.p.k dhe ortak i vetem i shoqerise, zoterues i 100 % te kuotave behet Bleresi Znj. Ana Shima.

Detyrimet per shoqerine e mesiperme fillojne per Bleresin nga dita e sotme.

Kjo kontrate shitje u perpilua ne baze te nenit 705 e vijues te K.Civil dhe te ligjit "Per noterine" si edhe te ligjit nr.9901 "Per Tregtaret dhe shoqerite tregtare"

Kjo kontrate shitje pasi iu lexua paleve kontraktues te cilet pasi e kuptuan dhe e gjeten sipas vullnetit te tyre te lire e te plote e nenshkruan rregullisht ne prani te Noteres.

SHITESI

Jeffrey Thimm
[Handwritten signature]

NOTERE
JOANA M. KUSHE
[Handwritten signature]

BLERESI

Ana Shima,
[Handwritten signature]



Regjistri i Barrëve Siguruese



Rr. e Dibrës, Qendra e Biznesit AK,
"Selvia", Kat V
TIRANE, SHQIPERË
TEL FAX: 0355 4 2420005
TEL: 0355 4 2420006
Email: rbs@rben-al.com

REZULTATET E KËRKIMIT

Numri i Rezultatit të Kerkimit:	D-20180529141934402
Data e Rezultatit të Kerkimit:	29.05.2018
Ora e Rezultatit të Kerkimit:	2:19:34PM
Lloji i Kerkimit:	
Numri i Dokumentit:	D-400-238-62
Referenca e Perdoruesit:	

LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERMIMI 0

JEFFREY MICHAEL THIMM
PEMLA SH.P.K.



M. Adoni